



VENDIM

Nr. 18, Datë 24/10/ 2017

**MBI MIRATIMIN E SHITESËS SË GRANTIT TË AKORDUAR NGA BUXHETI
I SHTETIT PËR UNIVERSITETIN E ARTEVE UART, RISHPËRNDARJA
NË BUXHETIN E INSTITUCIONIT SI DHE DISA NDRYSHIME NË RREGJISTRIN
E PROKURIMEVE PËR VITIN KALENDARIK 2017**

Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015, date 22.7.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", pika 3 e nenit 3, (liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë), nenit 49 (*Funksionet e Bordit të administrimit në institucionet e arsimit të lartë*). Bordi i Administrimit pasi dëgjoi relacionin e paraqitur nga Administratorja e Universitetit të Arteve, Znj. Alma Sinanaj, pasi u njoh me Vendimin e Senatit Akademik nr. 38, datë 11.10.2017 dhe pasi e diskutoi, me votim të hapur,

VENDOSI:

1. Miratimin e shtesës së grantit të akorduar nga buxheti i shtetit për Universitetin e arteve për vitin kalendarik 2017, sipas tabelës 1 (lidhja 1), bashkëlidhur këtij Vendimi;
2. Miratimin e shpërndarjes së të ardhurave të Uart për vitin kalendarik 2017, sipas tabelës nr.2 (lidhja 2), bashkëlidhur këtij Vendimi;
3. Miratimin e disa ndryshimeve në rregjistrin e prokurimeve për vitin kalendarik 2017, sipas tabelës nr.3 (lidhja 3), bashkëlidhur këtij Vendimi;
4. Bashkangjitur, vendimi i Senatit Akademik nr. 38, datë 11.10.2017, të Universitetit të Arteve;
5. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të UART.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.



BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Elira Kokona

(kryetar)

Prof. Artan Peqini

(anëtar)

Prof. Besnik Bisha

(anëtar)

Prof. Arben Basha

(anëtar)

Dhimitër Bako

(anëtar)

Erjon Ndroqi

(anëtar)

Arjan Konomi

(anëtar)